

1 E martë, 14 janar 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.02

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e
6 seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është lënda KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej për
12 procesverbal që të gjithë të akuzuarit janë të pranishëm në
13 sallën e gjyqit.

14 Sot do fillojmë me dëshminë e Dëshmitarit të Prokurorisë
15 W04264 i cili do të japë dëshmi përmes videolidhjes. Po ashtu
16 edhe Avokati Kujdestar i Dëshmitarit W04264 është i pranishëm
17 në vendndodhjen prej ku do të bëhet dëshmia.

18 Mirëmëngjes, z. Avokat. Ju lutem prezantohuni.

19 Z. KOCI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Mirëmëngjes, të
20 nderuar Gjykatës. Unë jam Arianit Koci, avokat nga Prishtina.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

22 Përpara se të vijë dëshmitari, dëshiroj t'ju informoj se
23 do të kemi një rend dite pak të ndryshuar. Fillimisht,
24 Dëshmitari 04264 do japë dëshmi çdo ditë deri në orën 12.30 me
25 përjashtim të rasteve ku do të ketë një kërkesë tjetër, do

1 bëjmë pushimet e rregullta në orën 10.00 dhe në orën 11.00.

2 Nëse lind nevoja, do bëjmë dhe pushime të tjera.

3 ZMMD-ja ka kërkuar që të jemi të kujdesshëm me pyetjet.

4 Dhe i referohem dokumentit F02797 që mban datën 18 dhjetor

5 2024. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues urdhëron palët që të jenë

6 shumë të kujdesshëm, t'i bëjnë pyetjet në rend kronologjik sa

7 i takon datave dhe ngjarjeve, të ndjekin ritmin e dëshmitarit

8 në mënyrë që t'i japin kohë që t'i rikujtoj gjërat dhe t'i

9 bëni pyetjet në mënyrë të hapur, joballafaquese, mos i

10 ushtroni trysni dhe ju lutem mos përsërisni pyetjet dhe mos

11 bëni pyetje sugjestionuese.

12 Kalojmë në seancë private, ju lutem.

13 [Seancë private]

14 [Seancë private teksti i fshirë]

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24 [Seancë e hapur]

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e
2 seancës, ju lutem sillni dëshmitari në ambientin ku ndodheni.

3 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit përmes
4 videolidhjes]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të uleni
6 -- jo, më falni, jo, një çast, qëndroni në këmbë një çast.

7 Dëshmitar, do ju lexoj betimin solemn të cilin duhet ta
8 ndiqni në bazë të rregullores së Gjykatës, rregulla 141(2). Ju
9 lutem përsërisni pas meje dhe në fund thoni nëse pajtoheni. Do
10 lexoj unë një fjali, do ta përsërisni ju derisa ta
11 përfundojmë.

12 E kuptoni, pra, do përsërisni pas meje, e kuptoni?

13 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po, po. Po.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë. Ky
15 është betimi solemn: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë
16 sime. Përsërisni pas meje.

17 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] I ndërgjegjshëm për
18 rëndësinë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për rëndësinë
20 e dëshmisë sime.

21 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] E dëshmisë sime.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe
23 përgjegjësinë time ligjore.

24 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Me përgjegjësinë time
25 ligjore.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Deklaroj
2 solemnisht se do ta them të vërtetën.

3 DËSHMITARI: Deklaroj solemnisht se do ta them të
4 vërtetën.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Krejt të
6 vërtetën.

7 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Krejt të vërtetën.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe vetëm të
9 vërtetën.

10 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Dhe vetëm të vërtetën.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe nuk do të
12 mbaj të fshehtë asgjë.

13 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Dhe nuk do të mbaj të
14 fshehtë asgjë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për të cilën
16 kam dijeni.

17 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Për të cilën kam
18 dijeni.

19 DËSHMITARI: SOKOL DOBRUNA

20 [Dëshmitari paraqitet përmes videolidhjes]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
22 Dëshmitar. Tani mund të uleni.

23 Dëshmitar, sot do fillojmë me dëshminë tuaj që mendohet
24 se do të zgjasë dy ditë. Në fillim do t'i bëjë pyetjet
25 Prokuroria, më pas edhe Ekipet e Mbrojtjes mund t'ju bëjnë

1 pyetje, por edhe Gjykatësit e Trupit Gjykues mund t'ju bëjnë
2 pyetje.

3 Prokuroria ka kërkuar një orë për pyetjet e veta. Ekipet
4 e Mbrojtjes së bashku kanë kërkuar gjashtë orë. Inkurajoj
5 palët të jenë sa më të kujdesshëm në shfrytëzimin e kohës që
6 ju është caktuar. Trupi Gjykues mund të lejojë pyetje
7 plotësuese nëse përmbushen kushtet.

8 Dëshmitar, përpiquni të përgjigjeni qartë me fjali të
9 shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje, lirisht kërkoni që
10 pyetja të përsëritet ose thjesht thoni që nuk e kuptoni që ta
11 sqarojmë. Gjithashtu, na thoni ku i bazoni ju faktet,
12 rrethanat për të cilat do t'ju bëjnë pyetje.

13 Në qoftë se Prokuroria ju thotë të përmendni korrigjimet
14 që i keni bërë deklaratave tuaja, ju duhet të konfirmoni për
15 procesverbal se deklarata me shkrim, bashkë me korrigjimet
16 përkatëse, pasqyron saktësisht dëshminë tuaj.

17 Flisni pranë mikrofonit dhe prisni pesë sekonda përpara
18 se të përgjigjeni edhe flisni ngadalë për përkthyesit.

19 Gjatë kohës që do të jepni dëshmi në sallën e gjyqit nuk
20 duhet të diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë suaj
21 jashtë Gjykatës. Nëse dikush jashtë Gjykatës ju bën pyetje për
22 dëshminë tuaj, na njoftoni menjëherë.

23 Ju lutem ndërprisni fjalën nëse ua kërkoj unë dhe
24 ndërprisni fjalën nëse e shihni që unë po ngre dorën. Kjo do
25 të thotë se unë duhet të jap një udhëzim.

1 Në çdo moment që keni nevojë për pushim, na thoni dhe do
2 të bëjmë organizimin përkatës.

3 E kuptojmë që ju keni një avokat, e kemi fjalën për
4 dokumentin F02723, në mënyrë që ju të merrni këshilla ligjore
5 nëse keni ndonjë shqetësim legjitim për vetëinkriminim.

6 Dëshmitar, sipas betimit solemn që sapo përsëritët pas
7 meje, jeni i detyruar të thoni të vërtetën. Sipas rregullores
8 sonë, unë ju them se nuk mund t'i përgjigjeni pyetjeve
9 vetëinkriminuese me përjashtim të rasteve kur ua kërkon vetë
10 Trupi Gjykses në përputhje me rregullën 151(2) dhe përcakton
11 se mund të jepen garancitë e rregullës 151(3).

12 Në qoftë se lind një pyetje vetëinkriminuese, ju mund ta
13 ngrini këtë me Avokatin tuaj Kujdestar dhe ne, si Trupi
14 Gjykses, do të vendosim pastaj nëse do t'i përgjigjeni pyetjes
15 apo jo dhe në çfarë rrethanash. Në një rast të tillë, vendimin
16 e merr vetëm Trupi Gjykses nëse përgjigjeni ju apo jo pyetjes.
17 Nëse Trupi Gjykses vendos që ju do të përgjigjeni, atëherë ju
18 jeni i detyruar t'i përgjigjeni pyetjes.

19 Do fillojmë me pyetjet e Prokurorisë pas një çasti, po do
20 pyes pak z. Koci. Z. Koci, ka ndonjë fushë sipas jush që mund
21 të jetë vetëinkriminuese, a ka ndonjë fushë që ju gjykoni se
22 duhet trajtuar tani me Trupi Gjykses, ndonjë fushë që mund të
23 jetë vetëinkriminuese për dëshmitarin.

24 Z. KOCI: [Përmes videolidhjes] Gjykatë e nderuar, unë kam
25 pas shumë pak mundësi me bisedu lidhur me lëndën me klientin

1 tim për shkak se thjesht nuk mundet me i përcjellë operacionet
2 pak më komplekse në këtë çështje. Kështu që, rrjedhimisht dhe
3 nuk kam pa asnjë indikacion se mund të vetëinkriminohet.

4 Mendimin --

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

6 Mirë. Në qoftë se del një situatë e tillë na njoftoni
7 menjëherë dhe do ta trajtojmë kut të vijë çasti.

8 Z. KOCI: [Përmes videolidhjes] Faleminderit.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do fillojmë
10 tani. Do fillojë Prokuroria. Dëgjojini me vëmendje ju lutem.

11 Z. Prokuror, fjala është për ju.

12 Z. CAPIN: [Përkthim] Faleminderit. Dhe mirëmëngjesi.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]
14 Përpara se të filloj pyetjet Prokuroria, më duhet të konfirmoj
15 për procesverbal se në vendndodhjen ku po jepet dëshmia është
16 i pranishëm, z. Arianit Koci, Avokati Kujdestar i Dëshmitarit
17 W0426 edhe unë, sekretarja së seancës.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni kujdes
19 se një mikrofon është i ndezur edhe ndikon tek mikrofonit që po
20 përdorë folësi.

21 Pyetje nga z. Capin:

22 Z. CAPIN: [Përkthim]

23 PY. Mirëmëngjesi, z. Dobruna.

24 PË. Mirëmëngjesi.

25 PY. Unë quhem John Capin dhe jam përfaqësues i Prokurorisë.

1 Mbase ju kujtohet që jemi takuar bashkë në Kosovë në nëntor,
2 para nja dy muajsh. Të kujtohet që jemi taku para nja dy
3 muajsh?

4 PË. Po.

5 PY. Ju lutem i thoni Trupit Gjykues emrin dhe mbiemrin tuaj.

6 PË. Sokol Dobruna.

7 PY. Ku, në cilin shtet jetoni ju?

8 PË. Në Kosovë.

9 PY. Në cilin qytet keni lindur?

10 PË. Në Gjakovë.

11 PY. Datëlindja juaj cila është? Kur keni lindur?

12 PË. 22 mars 1940.

13 Z. CAPIN: [Përkthim] Ju kërktoj ndjesë. Pata një shkëputje
14 përkthimi. Po marr përkthimin. Përkthimin nuk po e marr. Mbase
15 unë gabimisht kam bërë diçka, besoj se unë kam bërë diçka
16 gabimisht tek pajisja ime.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] As unë s'po e
18 marrë përkthimin në fakt.

19 Z. CAPIN: [Përkthim] Vazhdojmë. Mund të vazhdoj?

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
21 përkthyesit të thotë diçka.

22 Z. CAPIN: [Përkthim] Po e dëgjoj tani. Në rregull.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë jo.

24 PËRKTHYESJA: Gjykatësi nuk e merr përkthimin.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbase do

- 1 punonte po ta vendosja edhe kufjen në pajisje. Më falni.
- 2 Z. CAPIN: [Përkthim]
- 3 PY. Z. Dobruna, ju lutem përsëriteni dhe një herë datëlindjen
- 4 tuaj se pati një problem përkthimi?
- 5 PË. 22 mars 1940.
- 6 PY. Zotëri, çfarë profesioni keni?
- 7 PË. Avokat.
- 8 PY. Aktualisht e ushtroni profesionin e avokatit?
- 9 PË. Po.
- 10 PY. A përfaqësoni, aktualisht a shfaqeni ju në gjykatë, a
- 11 paraqisni çështje në gjykatë, përfaqësoni klientë në gjykatë?
- 12 PË. Po.
- 13 PY. Pra, a shkoni ju në gjykime për klientët tuaj, merrni
- 14 pjesë në gjykime?
- 15 PË. Po.
- 16 PY. Kur ka qenë hera e fundit që keni përfaqësuar një klient
- 17 në gjykatë?
- 18 PË. Dje.
- 19 PY. Çfarë lloj procesi ishte? Çfarë natyre kishte ky proces?
- 20 PË. Juridiko-civile.
- 21 PY. Ka qenë pasdite?
- 22 PË. Në ora 13.30.
- 23 PY. Sa orë keni qëndruar dje në gjykatë?
- 24 PË. Shumë pak.
- 25 PY. Me përfaqësi sa?

1 PË. Nuk është mbajtur seanca për shkak se nuk ka ardhë i
2 padituri.

3 PY. Ju keni dhënë deklaratë për Prokurorinë në vitin 2018.

4 Z. CAPIN: [Përkthim] I lutem Sekretarisë së seancës të
5 vendosë në ekran materialin që mban numrin 054739-TR-AT Pjesa
6 1 Rishikuar dhe përkthimin përkues në gjuhën angleze.

7 PY. A mund të konfirmoni për Trupi Gjykyes se i keni dhënë
8 deklaratë ZPS-së në 2018, e konfirmoni këtë?

9 PË. Nuk më kujtohet.

10 PY. A e mban mend që jemi takuar bashkë në nëntor të 2024,
11 para dy muajsh?

12 PË. Po.

13 PY. A të kujtohet që në atë takim që zgjati disa ditë, ne të
14 lexuam deklaratën që kishe dhënë në 2018, a e mban mend?

15 PË. Jo.

16 PY. Po a e mban mend që u takuam bashkë të premtën para ca
17 ditësh, javën e kaluar?

18 PË. Po.

19 PY. A të kujtohet që u takuam përmes videolidhjes, pra, ti
20 ishe në zyrën tënde, e mban mend?

21 PË. Po.

22 PY. Po avokati juaj, z. Koci, a ka qenë i pranishëm në atë
23 takim?

24 PË. S'po më kujtohet.

25 PY. A e mban mend që t'i më the që të kujtohej që më kishe

1 takuar në nëntor të 2024, e mbaje mend këtë?

2 PË. Jo, s'më kujtohet.

3 PY. Po a të kujtohet që mua më the që e mbaje mend që në
4 nëntor të 2024 ne të kishim rilexuar të gjithë deklaratën që
5 kishe dhënë në 2018, më the që e mbaje mend këtë?

6 PË. Më falni, nuk e kuptoj tërë materialin aty.

7 PY. Shiko, po e zbërthej pak pyetjen. Kur u takuam bashkë, a
8 e mban mend ti që ne folëm, ne folëm për deklaratën që kishe
9 dhënë më herët, pra, kur u takuam në nëntor të 2024 a e mban
10 mend që folëm për deklaratën e 2018 bashkë?

11 PË. Më falni a ka mundësi ta lexoni një deklaratë të tillë në
12 një mënyrë që të më kujtohet krejt.

13 PY. Jo, z. Dëshmitar, dua jua bëj pyetjen ndryshe. A e mban
14 mend që u takuam bashkë të premtën e javës së kaluar, e mban
15 mend që u takuam bashkë?

16 PË. Po.

17 PY. Edhe a të kujtohet që më the se takohej takimi ynë i
18 parë, takimi i parë që kishim pas bashkë, të kujtohej kjo?

19 PË. Nuk më kujtohet.

20 PY. A nuk ju kujtohet që vetë ju më thatë, a nuk ju kujtohet
21 që ju vetë më thatë që është shumë e lodhshme ky procesi që të
22 rishikojmë deklaratën që kam dhënë më përpara, nuk ju kujtohet
23 që më thatë që kjo është shumë e lodhshme, po më lodh shumë?

24 PË. Me siguri, po.

25 PY. A të kujtohet që ma the pra, këtë të premtën?

1 PË. Jo.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë që u çova në
3 këmbë, po a mund të na jepni një referencë të paktën pjesën ku
4 është folur që dëshmitari ka qenë i lodhur? Ku është kjo?

5 Z. CAPIN: [Përkthim] Patjetër. Një çast sa ta gjejmë. Ju
6 kërkoj ndjesë se nuk po e gjej pjesën përkatëse. Më falni,
7 është paragrafi 5 dhe do ta riformulojë pyetjen.

8 PY. Z. Dëshmitar, z. Dobruna, a ju kujtohet që unë ju thashë
9 shiko se unë dhe z. Koci jemi pajtu që të takohemi që t'ju
10 përgatisnim ju për dëshminë që do jepnit sot, a ju kujtohet që
11 ua thashë këtë?

12 PË. Po.

13 PY. A ju kujtohet që unë ju përmenda dhe detyrimin që ju
14 kishit për të tregu të vërtetën?

15 PË. Po.

16 PY. A ju kujtohet përgjigja që më dhatë?

17 PË. Nuk më kujtohet. Me siguri kam thënë se nënkuptohet që
18 duhet thënë të vërtetën para Gjykatës.

19 PY. A ju kujtohet që unë ju thashë ju që qëllimi i këtij
20 takimit është që të rishikojmë së bashku deklaratën që ke
21 dhënë më herët?

22 PË. Po.

23 PY. A ju kujtohet po ashtu që unë ju thashë që z. Koci ka
24 kopje në letër, kopje fizike të deklaratave tuaja dhe se ai do
25 ju ndihmojë ju nëse lind nevoja?

1 PË. S'kam përgjigje.

2 PY. A ju kujtohet që unë konkretisht ju thashë që unë si
3 Prokuror dhe z. Koci ishim pajtu që qëllimi apo theksi i
4 seancës përgatitore ishte që t'ju ndihmonim ju, t'ju
5 rifreskonim ju kujtesën për disa sqarime që mund t'i bënit ju
6 deklaratave që keni dhënë në të shkuarën, ky ishte qëllimi i
7 takimit të rishikonit deklaratat dhe të bënit korrigjime? Ju
8 kujtohet kjo?

9 PË. Jo.

10 PY. Z. Dëshmitar, a ju kujtohet që ju thatë se ju kujtohej që
11 ua kishin lexuar deklaratat që kishit dhënë në të shkuarën dhe
12 kishit shqetësim, kishit merak se korrigjimet mund të mos
13 ishin të sakta? E kemi fjalën korrigjimet që kishit bërë ju
14 vetë. Ju ishit i shqetësu se mbase nuk ishin të sakta këto
15 korrigjime, a ju kujtohet kjo?

16 PË. E di se ka pas korrigjime mjaft, por nuk më kujtohet se
17 cilat korrigjime që kam.

18 PY. Nuk është nevoja të flasim për të gjitha korrigjimet, po
19 a ju kujtohet që unë ju lexova, pra, në nëntor kur u takuam
20 bashkë unë ju lexova ju një dokument ku kishim pasqyruar ne të
21 gjitha korrigjimet që kishit bërë ju, ju kujtohet ky shënim që
22 ua lexova unë ju?

23 PË. Jo.

24 PY. Tani do t'ju bëj disa pyetje lidhur me ato çfarë më keni
25 thënë gjatë takimit të nëntorit, informacion i cili ju është

1 lexuar ju në kuadrin e asaj çfarë ne e quajmë Shënimi

2 Përgatitor numër 1.

3 Z. CAPIN: [Përkthim] Për procesverbal, z. Kryegjykatës,

4 Shënimi Përgatitor numër 1 ka numrin e identifikimit ERN

5 123558 deri në 123568.

6 PY. A ju kujtohet që një përkthyes në Kosovë gjatë disa

7 ditëve ju ka lexuar përmbajtjen e deklaratave të mëparshme që

8 keni dhënë ju, Dëshmitar, a ju kujtohet kjo?

9 PË. Jo.

10 Z. KOCI: [Përmes videolidhjes] Gjykatë e nderuar, kërkoj

11 falje për ndërprerjen. A mund të shkojmë për një kohë të

12 shkurtër në seancë të mbyllur?

13 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Nuk [E pakuptueshme].

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po. Le të

15 kalojmë në seancë private.

16 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Unë s'përgjigjem.

17 [Seancë private]

18 [Seancë private teksti i fshirë]

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21 [Seancë e hapur]

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

23 jemi në seancë të hapur.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dobruna,

25 në qoftë se ndryshoni mendje dhe në qoftë se dëshironi që të

Dëshmitari: Sokol Dobruna (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Capin

Faqe 16

1 kalojmë në seancë të mbyllur, ju lutem na e thoni këtë gjë ose
2 thojini avokatit të na e thotë këtë gjë në çdo moment mund të
3 ndërhyjni.

4 Mund të vazhdoni, z. Prokuror.

5 Z. CAPIN: [Përkthim] Faleminderit.

6 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Jashtë seancës publike
7 nuk dëshiroj me u përgjigj.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

9 Po e respektoj më dëshirën tuaj lidhur me këtë. Jemi në seancë
10 publike.

11 Z. CAPIN: [Përkthim]

12 PY. A ju kujtohet, z. Dobruna, që më thatë kur jemi takuar në
13 nëntor që keni korigjuar një emër të një zyrtari të Shteteve
14 të Bashkuara që keni përmendur në deklaratën tuaj të mëhershme
15 dhe që emri duhet të ishte James Rubin, a ju kujtohet kjo, z.
16 Dobruna?

17 PË. Nuk më kujtohet.

18 PY. A ju kujtohet që keni thënë konkretisht që ju besoni se
19 James Rubin është zyrtar i Departamentit të Shtetit Amerikan?
20 Do t'jua përsëris edhe një herë pyetjen. A ju kujtohet që më
21 keni thënë ju mua konkretisht që ju besoni se z. Rubin ishte
22 zyrtar i Departamentit të shtetit Amerikan?

23 PË. Nuk e di çfarë rëndësie ka kjo pyetje. Për mu nuk ka
24 rëndësi a kam thënë apo s'kam thënë, se aty s'kam dhënë
25 kurrfarë fakti i cili ka lidhje me dëshminë time.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
2 përpiquni që t'i përgjigjeni pyetjeve, z. Dobruna. Është e
3 rëndësishme për neve që të dëgjojmë përgjigjet e pyetjeve.
4 Z. CAPIN: [Përkthim]
5 PY. T'jua përsëris edhe një herë pyetjen?
6 PË. Jo.
7 PY. Çfarë përgjigje keni për këtë pyetje?
8 PË. Po. Po, më kujtohet.
9 PY. A ju kujtohet që lidhur me një deklaratë të dhënë prej
10 jush, në intervistën që keni pas me ZPS-në të keni thënë që ju
11 keni shkuar dhe keni lëvizur në të gjithë Kosovën kur keni
12 qenë të stacionuar në Divjakë dhe ka pasur një përjashtim
13 lidhur me këtë dhe ky përjashtim ka qenë kur në një makinë të
14 llojit xhip juve keni udhëtuar së bashku me Rexhep Selimin, a
15 ju kujtohet kjo?
16 PË. Jo, s'po më kujtohet. Po, po, po. Moment. Po.
17 PY. A ju kujtohet që unë ju kam pyetur në qoftë se ju keni
18 parë një të burgosur serb të vdekur në burgun e Kleçkës, a ju
19 kujtohet kjo?
20 PË. Kam problem me këtë kujtesë, ta hajë dreqi. Nuk po më
21 kujtohet. Po s'është me rëndësi. Mund të jetë. Nuk e mohoj. Po
22 ashtu po mendoj.
23 PY. Më konkretisht, a ju kujtohet që e keni bërë sqarime në
24 deklaratën tuaj duke më thënë mua që vendi ku e keni parë këtë
25 të burgosur ka qenë një qeli brenda një burgu, a ju kujtohet

Dëshmitari: Sokol Dobruna (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Capin

Faqe 18

1 kjo, Dëshmitar?

2 PË. Jo.

3 PY. A ju kujtohet që keni korrigjuar disa fjalë ose shumë
4 fjalë që ju pretendoni që nuk ishin përkthyer siç duhet, ju
5 kujtohet kjo, Dëshmitar?

6 PË. Nuk e di për cilat fjalë po flitni.

7 PY. Për shembull, fjala j-n-e, a ju kujtohet që ju thatë që
8 ishte shkruar gabim dhe quhej Jen dhe në fakt mënyra sesi
9 ishte shkruar ishte gabim që donte të thoshte diçka tjetër k-
10 e-n-i, a ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

11 PË. Jo, jo.

12 PY. A ju kujtohet që ju më thatë që ishte një fjala bista që
13 ishte shkruar keq dhe në vend të fjalës bista duhet të ishte
14 shkruar busti, ju kujtohet, Dëshmitar?

15 PË. Jo, jo. Thuaji bre se unë i kam harru krejt. E di që i
16 kam harru krejt [E pakuptueshme].

17 Z. CAPIN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mbase do ishte
18 me vend që z. Dobruna të konsultohet me avokatin e vet dhe të
19 bënim një pushim të shkurtër.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
21 pushim prej dhjetë minutash në mënyrë që të konsultohet
22 dëshmitari me avokatin.

23 Znj. Sekretare, mund ta nxirrni dëshmitarin nga vendi ku
24 jeni.

25 [Dëshmitari përfundon dëshminë përmes

1 videolidhjes]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
3 pushim prej dhjetë minutash.

4 --- Seanca ndërpritet në orën 09.41

5 --- Seanca rifillon në orën 9.47

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të kalojmë
7 në seancë private.

8 [Seancë private]

9 [Seancë private teksti i fshirë]

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20 [Seancë e hapur]

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
22 jemi në seancë të hapur.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
24 vazhdoni, z. Capin.

25 Z. CAPIN: [Përkthim] Faleminderit.

- 1 PY. Z. Dobruna, dëshiroj t'ju tërheq vëmendjen që të mendoni
2 pak për shtatorin e vitit 1998. A keni qenë ushtar ose a keni
3 qenë pjesëtar i UÇK-së në atë kohë, pra në shtator të 1998-s?
- 4 PË. Shtator? Prej 16 shtatorit.
- 5 PY. Afërsisht, kur jeni kyçur në UÇK?
- 6 PË. 7 shtator 1998.
- 7 PY. Fillimisht, ku keni qenë i stacionuar, Dëshmitar?
- 8 PË. Urdhëroni, edhe një herë?
- 9 PY. Kur jeni kyç në UÇK, në shtator të vitit 1998, ku keni
10 qëndruar, ku e keni pas vendin ku keni qëndruar?
- 11 PË. Në Jabllanicë.
- 12 PY. Çfarë roli apo çfarë funksioni keni luajtur ju atëherë?
- 13 PË. Fillimisht ushtar i thjeshtë. Pastaj, e kam luajt rolin e
14 moralitetit në luftë. S'po më kujtohet [E padëgjueshme].
- 15 Moral. Përgjegjës për moral.
- 16 PY. A ju kujtohet se si e kishte emrin komandanti juaj?
- 17 PË. Ramush Haradinaj.
- 18 PY. Ndërkohë që keni shërby në Jabllanicë, a e keni njoft
19 dikënd që quhej Lahi Brahimaj?
- 20 PË. Po.
- 21 PY. Çfarë roli ka pas ai?
- 22 PË. Si unë e kam pa në rresht kur janë rreshtu në mëngjes,
23 aty e kam njoft së pari. Pastaj nuk di.
- 24 PY. A ka pasur ndonjë rol ai në shtabin e përgjithshëm në
25 ndonjë kohë, Dëshmitar?

1 PË. Nuk më kujtohet se kam bisedu rreth asaj çështje as me
2 Ramushin, as me atë.

3 PY. A ju kujtohet që e keni dit këtë?

4 PË. S'po e kuptoj pyetjen. Cilën dijeni?

5 PY. A ju kujtohet që e ke pas dit që ai ka qenë gjithashtu
6 anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, ju kujtohet kjo?

7 PË. Nuk më kujtohet.

8 Z. CAPIN: [Përkthim] Do i kërkoja Trupit Gjykues që të më
9 jepte leje që t'i tregoj një deklaratë të mëhershme
10 dëshmitarit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mund të
12 vazhdoni.

13 Z. CAPIN: [Përkthim] Në kuadrin e problemeve me lexim, a
14 duhet t'ia lexoj këtë pjesë dëshmitarit, si thoni?

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Capin, unë
16 do thoja që do ishte më mirë që ta paraqesim dhe në ekran.

17 Z. CAPIN: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që tani të
18 paraqesë në ekran dokumentin duke filluar nga rreshti 24,
19 numër i identifikimit është 054739-TR-ET Pjesa 1, versioni në
20 shqip është Pjesa 1, e rishikuar, faqja 10, rreshtat 6 deri në
21 19.

22 PY. Z. Dobruna, do t'ju lexoj një pjesë të deklaratës që i
23 keni dhënë ZPS-së në vitin 2018. Juve ju bëhet pyetja:

24 "A mund t'ju pyes që përveç Ramush Haradinajt kush tjetër
25 ka qenë në komandë?"

1 Ju thoni që:

2 "Ka pasur një zëvendëskomandant që ka qenë si me, në
3 administratë, për, ka qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm që
4 ka vepru në kuadrin e zona operative ndërkohë që ka kontribu
5 në Shtab të Përgjithshëm si lidhje."

6 Më pas ju bëhet pyetja:

7 "A mund të na thoni si quhej ky person, si e kishte
8 emrin?"

9 Ti përgjigjesh:

10 "Të më kujtohet një herë se kam fillu dhe gjithë këto
11 vite i kam harruar emrat. Lahi Brahimaj ka qenë anëtari i
12 Shtabit të Përgjithshëm... por edhe i zonës operative ..."

13 A ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

14 PË. Jo, s'më kujtohet.

15 PY. A ju kujtohet që në vjeshtë të vitit 1998 jeni takuar me
16 anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm?

17 PË. Jo, nuk më kujtohet.

18 PY. A ju kujtohet që keni thënë që jeni takuar me Hashim
19 Thaçin dhe Jakup Krasniqin?

20 PË. Nuk më kujtohet. Me Jakupin kam qenë shok, veprimtar,
21 para luftës, dhe për atë jam taku pa dit për çka është fjala.
22 Atje kam shku me udhëzim të përfaqësuesit, Adem Demaçit, të
23 drejtave të njeriut në Kosovë. Edhe e kam përcjell [E
24 padëgjueshme].

25 Jakupi, se po më kujtohet se ai është, se kur e kam pyet

1 atë, i kam thanë, "A je ti komandanti", kam kujtu që është
2 komandant ai, "Jo", më ka thanë, "unë jam vetëm zëdhënës". Dhe
3 që kaq kam muhabet kam pas.

4 Z. CAPIN: [Përkthim] Atëherë, do kërkoj që të vendoset në
5 ekran materiali që mban numrin 054739-TR-ET, Pjesa 1, faqja
6 26, në rreshtin 20 fillojmë. Shqipja gjendet në materialin me
7 numër 054739-TR-AT, Pjesa 1, e Rishikuar, faqja 26, dhe fillon
8 në rreshtin 15. Kërkoj ndjesë.

9 PY. A ju kujtohet që ju është bërë një pyetje, dhe kjo është
10 në faqen 20 të transkriptit:

11 "A ju kujtohet kur keni qenë në Dukagjin, a ka pasur
12 ndonjë takim të Shtabit të Përgjithshëm?"

13 Dhe ju keni thënë:

14 "Po, më kujtohet që ka qenë Jakup Krasniqi. Që ka qenë
15 dhe shefi i... ka qenë dhe shefi i shtabit... Nuk më kujtohet
16 ... më falni, ka qenë dhe ky kryetari i shtetit që e harrova
17 emnin. Merre me mend se është kah më këputet filli që s'po më
18 kujtohet emri i kryetarit të shtetit. Merre me mend."

19 Ju është bërë pyetje:

20 "Kryetari aktual i shtetit?"

21 Ju jeni përgjigjur:

22 "Aktual i shtetit. Kjo është veç mungesa jeme. Po më
23 ngjan shumë shpesh."

24 Dhe kur ju tha, "Mos ka qenë Hashim Thaçi?", ju keni
25 thënë:

1 "Hashim Thaçi, më vjen keq, Hashim Thaçi dhe Jakup
2 Krasniqi kanë qenë atje të pranishëm dhe kemi bisedu."

3 Pra, z. Dëshmitar, a jeni takuar ju në vjeshtën e 1998-s
4 me z. Jakup Krasniqi dhe z. Hashim Thaçi?

5 PË. Nuk më kujtohet.

6 PY. A ju kujtohet që keni shkuar në Divjakë në dhjetor të
7 1998 për të marrë një pozitë të re brenda UÇK-së?

8 PË. Divjakë? Po.

9 PY. A shkuat ju atje sepse do të bëheshit shefi i shërbimit
10 juridik?

11 PË. Po.

12 PY. Kur ka ndodhur kjo në 1998?

13 PË. Më 16 dhjetor 1998.

14 PY. Kur shkuat në Divjakë, si e mësuat ju që do bëheshit
15 shefi i shërbimit juridik? Kush ua tha, domethënë, këtë gjë?

16 PË. Nuk më kujtohet se si, por e di që atje më është komunikuar
17 emërimi si shef i shërbimit juridik. Nuk më kujtohet si. Ka
18 kalu kohë, kohë shumë e gjatë, edhe -- [Folës që flasin
19 njëkohësisht]. Me leje, me leje. Ju po kërkoni prej meje edhe
20 pse është vërtetu se unë jam, ka harresa shumë keq. Por, nuk
21 po kuptoj këtë qasje të z. Prokuror. Absolutisht, unë nuk jam
22 në gjendje me i kujtu të gjitha. Nuk jam në gjendje.

23 PY. Kur shkove në Divjakë në dhjetor të 1998, a ju tha Jakup
24 Krasniqi ju se çfarë pune do të kryenit atje?

25 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Kundërshtoj, kjo është

1 pyetje orientuese.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

3 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju vetë na thatë sot
4 paradite që nuk duhet të bënin, nuk duhet të bënin pyetje
5 sugjestionuese.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këtë
7 kundërshtim konkret ua rrëzoj.

8 [Mikrofoni çaktivizuar] Z. Prokuror, mos bëni pyetje
9 orientuese, ju lutem, sugjestionuese.

10 Z. CAPIN: [Përkthim] E kuptoj.

11 PY. Z. Dobruna, para një çasti ju vetë thatë që kishit diskutu
12 me Jakupin rolin e ri që do të kishit ju në Divjakë. Kur
13 shkove në Divjakë, a ishte Jakup Krasniqi ai që u informoi ju
14 se do të ishit shefi i shërbimit juridik?

15 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] A mund të na japi një
16 referencë ku është përmendur kjo?

17 Z. CAPIN: [Përkthim] Po para një çasti vetë dëshmitari e
18 tha këtë gjë. Mund të shohim transkriptin provizor,
19 transkriptin e sotshëm, ju lutem.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, nuk e ka
21 thënë. Nuk e ka përmendur emrin.

22 Z. CAPIN: [Përkthim] Po më duket se ai e tha:

23 "Kur e pyeta unë, kur ishte komandant" -- më falni
24 atëherë.

25 Kur i bëra unë pyetje dhe e pyeta:

1 "A ju kujtohet që jeni takuar me z. Hashim Thaçi dhe z.
2 Jakup Krasniqi?"

3 Përgjigja e tij në rreshtat 4 deri në 6, ai ka thënë:

4 "Nuk më kujtohet. Me Jakupin, kemi qenë shokë dhe
5 veprimtarë që përpara luftës. Atje kam shkuar me udhëzim të z.
6 Adem Demaçit sepse ai mendonte se ai ishte komandant i
7 Jakupit, por në fakt ai më tha që ishte vetëm zëdhënësi. Kjo
8 është ajo që është thënë."

9 Sidoqoftë, keni të drejtë, duhet të më korrigjonit për
10 këtë.

11 PY. Z. Dëshmitar, ju vetë keni dijeni të këtë pasur ndonjë
12 urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm që ju emëronte ju si shef i
13 shërbimit juridik? Ka pas ndonjë urdhër për këtë?

14 PË. Me siguri mbasi m'u është komunikuar q'ashtu unë procedurën
15 nuk e di, qysh është ardh deri te ajo, por e di që kërkesa ka
16 qenë e Adem Demaçit.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë një
18 pushim tjetër.

19 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Udhëzimi --

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më falni, z.
21 Dëshmitar, se jua ndërpreva përgjigjen.

22 Do bëjmë dhjetë minuta pushim. Mund të largoheni nga
23 ambienti ku ndodheni.

24 [Dëshmitari përfundon dëshminë përmes
25 videolidhjes]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, do të doja
3 tani se sa kohë do t'i nevojitet Prokurorisë, se kështu si po
4 shkojnë gjërat do ketë ndryshim të parashikimeve kohore.

5 Z. CAPIN: [Përkthim] Po unë kam plan t'i marr pyetjet për
6 pyetje dhe aspekt për aspekt. Le ta vendosë Trupi Gjykses se
7 sa kohë më nevojitet mua. Është e sigurt se do më duhet më
8 shumë se një orë. Unë propozoj që të shohim sa kohë do më
9 nevojitet sot dhe pastaj e ripërshtasim kohën.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
11 Bëjmë pushimin tani dhe e diskutojmë kur të kthehemi.

12 --- Pauza fillon në orën 10.11

13 --- Seanca rifillon në orën 10.26

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj që
15 dikush do të fliste për diskutimet *inter partes*.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, i nderuar Kryegjykatës. Gjatë
17 pushimit të shkurtër ne patëm diskutim *inter partes* lidhur me
18 përdorimin e rregullës 154 -- 155, më falni, nga ZPS-ja për
19 pranimin e disa deklaratave si pjesë e provave gjyqësore dhe
20 ne si Mbrojtje nuk e kundërshtojmë këtë. Sidoqoftë do të donim
21 të bënim disa parashtrime lidhur me këtë. Ne do të diskutojmë
22 mënyrën se si do të pranohen deklaratat dhe për këtë ne nga
23 ana e Mbrojtjes kemi nevojë për gjysmë ore kohë. Dhe do ju
24 themi më konkretisht në orën 11.00.

25 Z. Koci, e kuptoni ju diskutimin që po bëhet këtu?

1 Z. KOCI: [Përmes videolidhjes] Po.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, kini
3 durim ju lutem. Ne na duhet gjysmë ore kohë që të përgatitemi.
4 Dhe do rikthehemi në orën 11.00.

5 --- Pauza fillon në orën 10.28

6 --- Seanca rifillon në orën 11.05

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Çfarë keni
8 për të thënë, çfarë keni për të raportuar?

9 Z. CAPIN: [Mikrofoni çaktivizuar].

10 [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ZPS-ja në këtë kohë do
11 bëjë një parashtrim në përputhje me rregullin 155(1) dhe do
12 kërkojë që të pranohen deklaratat e mëparshme të këtij
13 dëshmitari. Dhe mbështetur në komunikimet *inter partes* nuk ka
14 kundërshtime për pranimin e këtyre deklaratave të mëhershme të
15 dëshmitarit. Duke pasur parasysh atë çfarë kemi parë sot, dhe
16 zhvillimin e procesit gjyqësor, ne mendojmë që elementët e
17 rregullit 155(1) janë përmbushur.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

19 [Përkthim] Po kërkon që të pranohet i gjithë dokumenti,
20 të gjithë dokumentet?

21 Z. CAPIN: [Përkthim] Po. Atëherë, palët kanë rënë dakord,
22 dhe, në qoftë se është e nevojshme, jemi përgatitur që të
23 përshkruajmë secilin prej dokumenteve, megjithëse dokumentet
24 që unë do kërkoj që të pranohen janë më të gjera se sa
25 ç'parashikohet në paragrafin 1 të rregullës 155 [Sipas

1 përkthimit].

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do e bëni me
3 gojë apo me shkrim?

4 Z. CAPIN: [Përkthim] Si ta mendoni juve.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ju pyes
6 juve.

7 Z. CAPIN: [Përkthim] Me gojë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
9 kundërshtim palët?

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim. Prokurori me
11 të drejtë parashikoi atë -- parashtroi atë çfarë ne diskutuam.
12 Nuk kemi kundërshtim tjetër. Dhe Mbrojtja rezervon qëndrimin e
13 saj që t'i përcaktojë peshën e nevojshme deklaratave në
14 parashtrimet përfundimtare të saj.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

16 Z. capin, mund të vazhdoni.

17 Z. CAPIN: [Përkthim] Dokumenti SPO me numër 054739-TR-ET,
18 i Redaktuar, Pjesa 1 deri në 9, dhe përkthimet përkuese në
19 gjuhën shqipe në versionet e rishikuara të tyre dhe të
20 redaktuara nga Pjesa 1 deri në Pjesën 9 kërkohen prej nesh që
21 të pranohen si prova gjyqësore.

22 Dokumenti i dytë, i nderuar Gjykatës, është dokumenti me
23 numër identifikimi SITF00010487, deri në SITF00010508, i
24 redaktuar.

25 Po ashtu këto dokumentet që do të citoj më poshtë janë

1 prova të lidhura me deklaratat e përmendura më herët. Këto
2 dokumente janë: dokumenti me ERN 056333 -- ju kërkoj ndjesë.
3 Në gamën e dokumenteve 0656312 [Sipas përkthimit] deri në
4 0656340.

5 Domethënë, nga kjo faqe nga 06 në këtë gamë dokumentesh
6 kërkoj që të pranohet dokumenti 056335. Ose më mirë, të
7 nderuar Gjykatës, do ishte më mirë që të kërkonim që të
8 pranoheshin të gjitha faqet, pra nga 0656312 deri në 0656340
9 [Sipas përkthimit].

10 Të nderuar Gjykatës, në pajtim me atë çfarë ramë dakord
11 me palët, kërkojmë gjithashtu që të pranohet në prova
12 gjyqësore dokumenti 054664 deri në 054703, i redaktuar.
13 Dokumenti në shqip ka të njëjtin numër ERN-je dhe kërkojmë
14 gjithashtu që të pranohet në prova gjyqësore dokumenti 054704
15 deri në 054734, dhe përkthimi i këtij dokumenti në shqip që ka
16 të njëjtin numër ERN-je.

17 Kjo ishte përmbledhja e dokumenteve.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë, këto
19 dokumente kërkoj që të pranohen në përputhje me rregullën
20 155(1)?

21 Z. CAPIN: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Gjithashtu,
22 nuk lashë, nuk përmenda Shënimin Përgatitor 1 që po ashtu
23 është dokument për të cilin ramë dakord midis palëve. Ka numër
24 ERN-je 123558 deri në 123568.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë

1 kundërshtim?

2 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po mendohem, po mundohemi që të
3 gjurmojmë atë çfarë tha Prokurori, por kam përshtypjen që ne u
4 pajtuam gjithashtu që të pranohet edhe dëshmia e vitit 2013,
5 dhe jo vetëm kaq, por dhe provat shoqëruese. Së pari Prokurori
6 kërkoi që të pranojmë vetëm një faqe, ndërkohë që tani tha që
7 dëshiron që të pranohen të gjitha faqet e dokumentit, e gjithë
8 gama e dokumentit. Thjesht po bëjmë konstatimet përkatëse,
9 verifikimet përkatëse. Për momentin nuk kemi kundërshtim, por
10 do ta themi kundërshtimin në qoftë se nuk ka ndonjë gjë për të
11 shtuar.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, duket
13 sikur ka një, kjo nuk ka përputhshmëri për të gjitha faqet, të
14 gjitha dokumentet.

15 Z. CAPIN: [Përkthim] Mendoj i nderuar Gjykatës, që neve u
16 pajtuam që të pranojmë në prova gjyqësore dokumente të cilat
17 janë të cituara në poshtëshënimin 53 të parashtimit të
18 protokolluar F02720.

19 Sa i takon deklaratës së 2013, mendoj që i përmenda të dy
20 numrat, të dyja numrat ERN, mbase e kam thënë gabimisht. Nuk e
21 di.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Që të jemi të qartë, që ta ketë të
23 qartë Trupi Gjykses, ajo çfarë diskutuam ndërmjet palëve është
24 që, pra, kemi paketën e 154 që bie në fushën e veprimit të
25 rregullës 155 dhe dëshmisë së vitit 2013, por na duhet që

1 numrat ERN të jenë të sakta, duhet t'i konstatojmë këto.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, po. Edhe Shënimi Përgatitor
4 numër 1 që po ashtu është pjesë e paketës së 154. Po, edhe ky
5 duhet që të citohet si dokument.

6 Z. ROBERTS: [Përkthim] Atëherë mund ta lexoj për
7 procesverbal, në mënyrë të tillë që të jemi të sigurt që është
8 kërkuar që të pranohet në provë gjyqësore.

9 Unë, sa i takon dëshmisë së 2013 kam këtë numër ERN-je.
10 054664 deri 054703, faqja e dytë e kësaj dëshmie ka numrin
11 054704 deri në 054734.

12 Z. CAPIN: [Përkthim] Për këtë kemi rënë dakord, i nderuar
13 Gjykatës.

14 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se mund ta
16 ndihmojmë Prokurorin. Problemi me të gjitha faqet që ju
17 përmendët është se në pajtim me grafikun që keni parashtruar
18 sipas 154, një pjesë e këtyre dokumenteve janë të pranuar në
19 prova gjyqësore.

20 Z. CAPIN: [Përkthim] Po, keni të drejtë.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull.

22 Z. CAPIN: [Përkthim] Ndoshta do ishte më mirë që të
23 kalojë faqje pas faqeje, në mënyrë të tillë që të jenë të
24 qarta për procesverbal.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,

1 vazhdoni, por flisni ngadalë.

2 Z. CAPIN: [Përkthim] Po, faleminderit. Ka gjashtë faqe.

3 Dokumenti i parë është nga 056312 deri në 056340, dhe
4 faqja e vetme që kërkojmë që të pranohet nga ky numër faqesh
5 është ajo me numër 056333.

6 E dyta nga kjo, nga këto gamë faqesh janë 056335, dhe
7 përkthimi përkues në anglisht që ka numrin 056335 deri në
8 056335-ET.

9 Të nderuar Gjykatës, dokumenti i tretë është 056341, deri
10 në 056341.

11 Faqja e katërt është ajo me numër SITF00010511 nga
12 dokumenti më i gjatë me numër identifikimi SITF00010509 deri
13 në SITF00010563.

14 Dokumenti i pestë është nga i njëjti, e njëjta gamë
15 faqesh, por faqja konkrete që kërkoj që të pranohet si provë
16 gjyqësore është SITF00010512 deri në SITF00010532.

17 Dhe dokumenti i fundit, i nderuar Gjykatës, është nga e
18 njëjta gamë faqesh, por ka numrin konkret SITF00010533 deri në
19 SITF00010555.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
21 problem me këto faqe?

22 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo, tani jo.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

24 Z. DIXON: [Përkthim] As ne nuk kemi kundërshtime. Por
25 thjesht dua që të theksoj dhe një herë kontekstin, për shkak

1 të rrethanave shumë të veçanta të këtij dëshmitari, për këtë
2 arsye nuk bëjmë kundërshtime. Duke marrë parasysh që kjo
3 lidhet me veprimet edhe sjelljen e të akuzuarit, megjithatë,
4 domethënë, do bëjmë parashtrimet përkatëse kur të jetë e
5 nevojshme, por në rastin konkret për specifikat e këtij
6 dëshmitari nuk kemi kundërshtime.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
8 për sqarimin.

9 Znj. Alagendra.

10 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim, por i
11 bashkohemi parashtrimeve të bëra nga z. Dixon.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
13 Dokumentet që u përmendën nga Prokurori, pranohen sipas
14 rregullës 155(1) sipas Rregullores së Gjykatës. Dhe dua të
15 them gjithashtu që edhe Shënimi Përgatitor numër 1 që u
16 identifikua me numrin përkatës ERN nga Prokurori pranohet në
17 prova gjyqësore.

18 A ka ndonjë gjë tjetër për të thënë lidhur me këto
19 dokumente?

20 Z. CAPIN: [Përkthim] Jo.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për të sqaruar çështjen, z.
22 Capin juve përmendën rregullën 155(1). A mund të na thoni për
23 procesverbal se cilën alternativë të këtij rregulle është
24 bërë, është rënë dakord ndërmjet palëve? Domethënë, cila
25 është, në cilën germë të rregullës 155(1) keni rënë dakord

1 ndërmjet palëve?

2 Mbase mund të jetë më mirë që të kalojmë në seancë
3 private për këtë, në qoftë se është e nevojshme.

4 Z. CAPIN: [Përkthim] Do ishte më mirë të kalojmë në
5 seancë private.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të kalojmë
7 në seancë private.

8 [Seancë private]

9 [Seancë private teksti i fshirë]

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8 [Seancë e hapur]

